



STATUT

SHOQATA SHQIPTARO-AMERIKANE "USKANA"
ALBANIAN-AMERICAN ASSOCIATION "USKANA"



PËRMBAJTJA

NENI 1 - EMËRTIMI DHE SELIA	3
NENI 2 - VULA	3
NENI 3 – OBJEKTIVAT	3
NENI 4 – KOHËZGJATJA	5
NENI 5 - ANËTARËSIA	5
NENI 6 – ORGANET DREJTUESE TË SHOQATËS	6
NENI 7– KUVENDI I PËRGJITHSHMË I ANËTARËVE	7
NENI 8 – KRYESIA E SHOQATËS	8
NENI 9 - DREJTUESIT	9
NENI 10 - ANËTARET E NDERIT	10
NENI 11 - FONDET	11
NENI 12 – NDRYSHIMET	11
NENI 13- SHPËRNDARJA	11
NENI 14 – ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE	12
STATUTI I APROVUAR DHE NËNSHKRIMET NGA KRYESIA	13
SHTOJCË – NDRYSHIMET NË STATUT	14



NENI 1 - EMËRTIMI DHE SELIA

Emërtimi i Shoqatës është: “Shoqata Shqiptaro-Amerikane Uskana”. Selia e Shoqatës është në Chicago. Shoqata do të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e SHBA ku vepron dhe jeton diaspora kërçovare duke krijuar edhe degë në qytete ose vende të tjera ku është e përqëndruar diaspora kërçovare.

NENI 2 - VULA

Organizata ka një vulë e cila do të jetë në formë të rumbullakët. Në gjysëmharkun e sipërm shkruan “Shoqata Shqiptaro-Amerikane Uskana” kurse në gjysëmharkun e poshtëm shkruan “Albanian-American Association Uskana”.

Vula do të jetë nën ruajtjen e Sekretarit, i cili e vendos atë në të gjitha dokumentat që duhet të vulosen.

Një riprodhim i vulës zyrtare mund t’i besohet secilit anëtar të autorizuar nga Kryesia e Shoqatës për të vepruar si agjent për Shoqatën në çdo çështje në të cilën kërkohet që një dokument të jetë i vulosur.

NENI 3 – OBJEKTIVAT

Kjo Shoqatë krijohet si një organizatë jo fitimprurëse. Shoqata do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin e shtetit të Illinoisit si dhe në përputhje me legjislacionin e shtetit të Illinois dhe legjislacionit federal amerikan.

Shoqata është një shoqatë kulturore, edukative dhe shkencore, qëllimet e së cilës janë:



- a. Të inkurajojë dhe zhvillojë aktivitetin e saj për ruajtjen e gjuhës, traditës dhe kulturës shqiptare në përgjithësi e Kërçovare në veçanti, shënimin e datave me rendësi kombëtare, organizimin sipas mundësive të shkollave me mësim në gjuhën amtare dhe të vendosë marrdhëniet e saj me disiplina të tjera akademike;
- b. Të inkurajojë dhe zhvillojë kulturën shqiptare tek brezat e ri dhe marrdhëniet e saj me disiplina të tjera;
- c. Të organizojë konferenca dhe mbledhje për të diskutuar problemet e diasporës Kërçovare dhe për të shkëmbyer pikëpamje për çështje që kanë të bëjnë me gjithë komunitetet tjera shqiptare në SHBA;
- ç. Të shesë, blejë, marrë si dhurime, çdo trashëgimni, pronë apo dhurim për objektivat e Shoqatës;
- d. Të japë grante, bursa studimi apo ndihma financiare individëve, grupeve të personave apo organizatave në përputhje me objektivat e Shoqatës;
- dh. Të botojë gazeta, revista, libra dhe monografi që kanë të bëjnë me aktivitetet e diasporës Kërçovare;
- e. Të lehtësojë aplikimin e anëtarëve të saj për grante për projekte që kanë të bëjnë me arsimin e gjeneratave të reja;
- f. Të organizojë të gjitha aktivitetet me qëllim të mbledhjes të fondeve financiare për të realizuar objektivat e saj;
- g. Të vendosë lidhje me institucionet në vendlindje duke filluar nga ato lokale, qendrore dhe mbarëshqiptare duke krijuar marrdhënie të mira reciproke;
- h. Organizimin vjetor të manifestimit tradicional "Sofra Kërçovare" që do të organizohet nën ombrellën e Shoqatës;
- i. Organizim vjetor të projektit Recital Muzikor 'AMA' për shqiptarët nga të gjitha trojet, organizuar nën ombrellën e Shoqatës, sipas marrëveshjes me koordinatorin e Recitalit Muzikor 'AMA';
- i. Shoqata Uskana që vepron në SHBA dhe Kryesia e saj pranojnë si obligim që të ndihmojnë në organizimin e mërgatës Kërçovare me rastin e zgjedhjeve lokale të komunës së Kërçovës duke e pasur parasysh se vota e mërgatës është vendimtare për të siguruar administratën shqiptare të komunës së Kërçovës;



Shoqata si e tillë nuk do të marrë përsipër vetë apo nënpërmjet anëtarëve të saj të përmbushë çfarëdo kërkesë të politikës publike përderisa nuk ekziston lidhje direkte me interesat e Shoqatës në të cilën ushtron aktivitet për të përmbushur qëllimet e saj;

Shoqata është jopolitike dhe e pavarur dhe ka statutin e vet, mirëpo duke pasur parasysh që çeshtjet e shqipëtarëve në trojet tona janë akoma të pazgjedhura dhe nëse Kryesia e Shoqatës e sheh të arsyeshme që një iniciativë apo veprim është në të mirë të popullit shqiptar dhe mund të përmirësojë gjendjen e bashkëkombasve tanë atëherë Shoqata do angazhohet me fuqinë e plotë në këto iniciativa e veprime.

Po ashtu Shoqata do të solidarizohet me kërkesat legjitime të popullit shqiptar në Ballkan dhe do të ndikojë në shoqërinë dhe administratën amerikane me qëllim të realizimit të projekteve Kombëtare dhe mirëqenien shqiptare.

Si pjesë e komunitetit shqiptaro-amerikan Shoqata është e gatshme për bashkëpunim me shoqatat apo organizatat tjera me qëllime të perbashkëta.

NENI 4 – KOHËZGJATJA

Kjo Shoqatë krijohet për një periudhë të pacaktuar kohore.

NENI 5 - ANËTARËSIA

Anëtarësia në Shoqatë është e hapur, e lirë dhe vullnetare për të gjithë ata të cilët pranojnë objektivat e përcaktuara në këtë Statut. Në Shoqatë mund të anëtarësohen të gjithë kërçovarët pavarësisht: nga gjinia, gjendja shoqërore, feja, banimi, puna, moshë, kurse kontributin vjetor e paguajnë të gjithë anëtarët mbi moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeq;

Në Shoqatë të drejtë anëtarësimi ka çdo qytetar amerikan që shfaq ndjenja miqësie dhe admirimi ndaj popullit shqiptarë me kusht që pranimi i tij mos jetë në kundërshtim me statutin e shoqatës;

Anëtarësia mund të përfshijë si individë ose institucione. Në rastin e individëve, një person mund të bëhet anëtar i Shoqatës si grupe të organizuara të cilat pranojnë statutin e kësaj shoqate;

Anëtarët kanë të drejtë:



- Të marrin pjesë dhe të organizohen në punën e shoqatës;
- Të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet e shoqatës;
- Të informohen për aktivitetin dhe veprimet e shoqatës;
- Të japin propozime, vërejtje dhe sygjerime;
- Të ruajnë nderin, dinjitetin dhe interesat e shoqatës;

Obligimet e anëtarësisë:

- Të paguajnë kontributet siç parashikohet prej këtij Statuti;
- Të ndjekin rregullat e parashikuara nga ky statut;
- Të mospërfitojnë nga aktivitetet e kryera nga shoqata;
- Çdo anëtarë i rregullt ose anëtarë nderi i nënshtrohet statutit dhe vendimeve të Kuvendit me: ndershmëri, punë dhe bindje atdhetare;
- Të punojë e ndikojë që çdo anëtarë të jap kontribut të dukshëm në fushën që dëshiron: kulturë, art, sport, shkencë, humanizëm etj;

Anëtarët humbasin të drejtën e tyre të anëtarësisë në Shoqatë në rastet e mëposhtme:

- Paraqitje e dorëheqjes vullnetare;
- Shkelje e rregullave të parashikuara nga ky Statut;
- Shpërndarje e Shoqatës;
- Mos pagesa e kontributit vjetor brenda viti;
- Veprimet kompromituese që dëmtojnë prestigjin e shoqatës;

Pagesa vjetore bëhet në tre-mujorin e parë kurse anëtarët e rinj paguajnë menjëherë prej ditës kur anëtarësohen.

NENI 6 – ORGANET DREJTUESE TË SHOQATËS

Organet drejtuese të Shoqatës janë:

- Kuvendi i Përgjithshëm i Anëtarëve
- Kryesia e Shoqatës
- Kryetari
- Zëvendës Kryetari
- Sekretari
- Zëvendës Sekretari
- Arkëtari
- Zëvendës Arkëtari



- Anëtarët e Kryesisë

NENI 7– KUVENDI I PËRGJITHSHMË I ANËTARËVE

Të gjithë anëtarët e Shoqatës kanë të drejtë të marrin pjesë dhe të votojnë në Mbledhjen e Kuvendit të Përgjithshme të Anëtarëve. Mbledhja e Kuvendit të Përgjithshme e Anëtarëve mund të mbledhet në Mbledhje të Zakonshme ose në Mbledhje të Jashtëzakonshme. Çdo anëtar ka të drejtën e një vote në Mbledhjen e Përgjithshme të Kuvendit. Shoqata do të organizojë të paktën një Mbledhje të Përgjithshme të Zakonshme të Kuvendit në çdo vit kalendarik.

Njoftimi për Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore të Kuvendit, kohën, vendin dhe përmbajtjen, do t'u dërgohet me email të gjithë anëtarëve në adresat e tyre të përcaktuara në librin e anëtarëve të Shoqatës të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para ditës së Mbledhjes së Përgjithshme të Zakonshme.

Kuvendi i Përgjithshme i Anëtarëve vendos mbi:

- a. Zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë dhe anëtarët e nderit;
- b. Heqjen nga detyra të anëtarëve të Kryesisë dhe drejtuesve të tjerë të Shoqatës.
- c. Pranimin dhe përjashtimin e anëtarëve të Shoqatës;
- ç. Miratimin e deklaratave financiare, raportin e shpërndarjes së fondeve dhe për orientimet e përgjithshme të Shoqatës;
- d. Ndërrimin e emrit të shoqatës;
- f. Ndryshimin e formës së Shoqatës në një formë tjetër juridike ose bashkimin apo shpërndarjen e saj;

Prania e jo më pak se 50% (pesëdhjetë përqind) e të gjithë anëtarëve do të përbëjë quorum për Mbledhjet e Përgjithshme të Zakonshme të Kuvendit dhe shumica e thjeshtë e të pranishmëve do të jetë e nevojshme për të marrë vendime (minimum 40 anëtarë të pranishëm). Për ndryshimin e Statutit, përjashtimin e një anëtari, dhe shpërndarjen e Shoqatës duhet të jenë të pranishëm të paktën 3/4 e anëtarëve. Për heqjen nga detyra të anëtarëve të Kryesisë edhe në rastin kur kjo është propozuar nga vetë Kryesia, apo organeve të tjera drejtuese të Shoqatës, nevoitet vota e 2/3 së anëtarëve



të Shoqatës të pranishëm.

Kryetari i Shoqatës mund të thërrasë Mbledhjen e Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Kuvendit të Shoqatës kur e gjykon të nevojshme një gjë të tillë për interesin e Shoqatës. Procedura e njoftimit për mbledhje të tilla do të jetë e njëjtë me atë të Mbledhjes së Zakonshme. Lajmërimi duhet të përmbajë arsyet e mbledhjes, çështjet që do të trajtohen në këtë mbledhje dhe cili ka kërkuar organizimin e mbledhjes. Kryetari duhet të thërrasë Mbledhjen e Jashtëzakonshme me kërkesën e anëtarëve të Kryesisë.

Procesverbali i çdo Mbledhje të Përgjithshme do të shkruhet prej Sekretarit dhe do të nënshkruhet prej tij, ose prej çdo personi tjetër i caktuar me vendim të Kryesisë dhe Kryetarit.

NENI 8 – KRYESIA E SHOQATËS

Kryesia e Shoqatës do të jetë i përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:

- a. Kryetari, Zëvendës Kryetari, Sekretari, zv. Sekretari, Arkëtari dhe zv. Arkëtari të cilët zgjidhen çdo 2 vjet me të drejtë rizgjedhje;
- b. 5 (pesë) anëtarë të tjerë të cilët zgjidhen për një afat prej dy vitesh, me të drejtë rizgjedhje.

Kryesia e Shoqatës vepron vetëm në emër të Shoqatës. Ajo do të ketë kompetencat e mëposhtme:

- a. Kontrollon dhe drejton aktivitetin e Shoqatës;
- b. Mund të punësojë ose pushojë nga puna personel në përputhje me nevojat e Shoqatës;
- c. Do të jetë i përgjegjshëm për programet e publikimeve dhe konferencave të shoqatës;
- ç. Mund të bëjë shpërndarjen e parave sipas programeve;
- d. Propozon kontributin e pagesës për anëtarët e shoqatës dhe kuotën e abonimit në botimet e shoqatës;
- e. Gjithashtu mund të krijojë komisione të caktuara duke i caktuar edhe detyrat



përkatëse;

- ë. Zgjedh Kryetarin, Zëvendës Kryetarin, Sekretarin, Zëvendës Sekretarin, Arkëtarin dhe Zëvendës Arkëtarin në mbledhjen e parë të Kryesisë pas Kuvendit të Përgjithshëm Vjetor të Anëtarëve;
- f. I propozon Kuvendit të Përgjithshëm të Anëtarëve shkarkimin nga detyra të ndonjërit të anëtarëvetë Kryesisë në rast nevojë;
- g. Plotëson vendet bosh në Kryesi dhe drejtuesit e Shoqatës të shkaktuar nga vdekja, dorëheqja, pushimi nga detyra ose dështimi në zgjedhje, duke caktuar këta persona të qëndrojnë në detyrën e zgjedhur deri në zgjedhjet e ardhshme.
- h. Kryesia e Shoqatës do të mbledhet të paktën dy herë në çdo vit kalendarik. Kryesia e Shoqatës mund të mbledhet me kërkesë të Kryetarit ose në bazë të kërkesës me shkrim të 3 anëtarëve të Kryesisë. 7 (shtatë) anëtarë të Kryesisë përbëjnë quorum dhe shumica e votave të pranishmeve do të jetë e nevojshme për marrjen e vendimeve.

Njoftimi për mbledhjen e Kryesisë do të jepet të paktën 3 ditë përpara ditës së caktuar për mbledhje, vetëm në rastin kur anëtarët e Kryesisë do të jenë të gjithë të pranishëm.

Çdo anëtar i Kryesisë ka të drejtën e një vote.

Kryesia e Shoqatës mund të hartojë rregulla dhe rregullore për organizimin e mbledhjeve të saj.

NENI 9 - DREJTUESIT

Kryetari, drejton të gjitha mbledhjet e Shoqatës. Në mbledhjen e parë të Zakonshme të Kuvendit të Anëtarëve të Shoqatës, do të paraqesë një raport vjetor për punën e Shoqatës. Kryetari do të ketë ato kompetenca që janë të nevojshme për një përfaqësues ligjor të Shoqatës dhe duhet të vërë në jetë vendimet e Kryesisë. Kryetari ka të drejtë të përfaqësojë Shoqatën përpara palëve të treta. Kryetari autorizon shpërndarjen e të gjitha mjeteve financiare të Shoqatës, sipas vendimeve të marra nga organet kompetente. Kryetari zgjidhet për një afat kohor 2 vjeçar nga Kryesia e Shoqatës në



mbledhjen e parë pas Mbledhjes së Përgjithshme Vjetore të Kuvendit të Anëtarëve.

Zëvendës Kryetari, ndihmon Kryetarin në të gjitha detyrat e tij zyrtare. Në mungesë ose pamundësi të Kryetarit, Zëvendës Kryetari do të ushtrojë funksionet dhe do të veprojë si Kryetari i Shoqatës me të drejtat, privilegjet dhe kompetencat që ka Kryetari në mungesë ose pamundësi.

Sekretari, do të mbajë procesverbalet dhe të dhënat e Shoqatës në librat përkatës. Ai jep dhe dërgon të gjitha njoftimet për anëtarët e Shoqatës. Ai është ruajtësi zyrtar i vulës së Shoqatës. Ai mund të jetë një nga drejtuesit që kanë të drejtë të nënshkruajnë çeqe dhe urdhër pagesa në emër të Shoqatës. Ai do t'i paraqesë Kryesisë çdo njoftim apo komunikim që i është drejtuar atij si Sekretar i Shoqatës. Ai do të mbajë të gjithë korrespondencën e Shoqatës dhe do të ushtrojë të gjitha detyrat që lidhen me funksionin e Sekretarit.

Zëvendës Sekretari, ndihmon Sekretarin në të gjitha detyrat zyrtare dhe në mungesë ose pamundësi të Sekretarit, do të ushtrojë detyrat e Sekretarit të Shoqatës.

Arkëtari, përgatit në periudhat e parashikuara, të vendosura nga Kryesia, deklarata me shkrim të financës së Shoqatës dhe një raport i tillë i bashkëngjitet fizikisht procesverbalit të mbledhjeve të Kryesisë. Do të ushtrojë të gjitha detyrat e lidhura me funksionin e financave. Do të kontrollojë pasqyrat financiare vjetore të Shoqatës. Shqyrton dhe raporton mbi çfarëdo çështje tjetër financiare të Shoqatës sa herë që kjo kërkohet nga Kryesia e Shoqatës.

Zëvendës Arkëtari, ndihmon Arkëtarin në të gjitha detyrat zyrtare dhe ushtron detyrën e Arkëtarit të Shoqatës në mungesë të tij

NENI 10 - ANËTARET E NDERIT

Duke pasur parasysh punën e palodhur të gjeneratave dhe personaliteteve kërcovare në një kohë të gjatë në mërgim, për veprat e tyre që gjithmonë të mbeten prezent në mesin tonë dhe të barten gjithashtu tek brezat e rinjë, Shoqata vendosi që të formojë organin Anëtarët e Nderit.

Kuvendi i Shoqatës do të bëjë pranimin e anëtarëve të nderit çdo vit në mbledhjen e rregullt. Anëtarët e Nderit sipas dëshirës ose sipas kërkesave mund të jenë present në çdo lloj aktiviteti të shoqatës. Anëtarët e Nderit nuk janë të obliguar të paguajnë anëtarësinë vjetore. Anëtarët e Nderit poashtu do të ndihmojnë në mosmarrveshjet mbrenda shoqatës duke respektuar nenin 14. Shoqata do të nderojë vetëm kryetarin e



parë themelues të shoqatës, me titullin Kryetar Nderi.

NENI 11 - FONDET

Fondet e Shoqatës përbëhen prej:

- a. Kuotave dhe kontributeve të të gjithë anëtarëve;
- b. Financimeve dhe donacioneve të bëra prej individëve dhe/ose personave juridikë.

NENI 12 – NDRYSHIMET

Të drejtë për ndryshime në këtë statut mund ta kenë:

- Kuvendi i Shoqatës;
- Kryesia e Shoqatës si dhe çdo anëtarë i Kryesisë ka të drejtë të propozojë ndryshime për statutin, mirepo Kuvendi është organi më i lartë i Shoqatës dhe ndryshimet në statut duhet të miratohen në Kuvend.
- Kuvendi vendos në ndryshimin vjetorë të kuotës së anëtarëve sipas nevojës;

NENI 13- SHPËRNDARJA

Nëse Shoqata shpërndahet nga Mbledhja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme e Anëtarëve, me praninë e të paktën 3/4 të anëtarëve. Kjo mbledhje emëron një komision likuidimi. Komisioni i likuidimit likujdon Shoqatën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Nëse Shoqata është shpërndarë me vendim të gjykatës kompetente, kjo e fundit emëron një komision likuidimi. Në rastin e shpërndarjes të gjitha pasuritë e shoqatës, pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve, do t'i shpërndahen një apo më shumë organizatave bamirëse.



NENI 14 – ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij Statuti, e lindur gjatë kohëzgjatjes së kësaj Shoqate, fillimisht tentohet të zgjidhet me mirëkuptim. Nëse çështja nuk zgjidhet miqësisht, çdo mosmarrëveshje, kundërshtim, apo ankim që lind apo lidhet me këtë Statut, apo zgjidhje, mbarim apo pavlefshmëri të saj, do të zgjidhet prej Kuvendit.



STATUTI I APROVUAR DHE NËNSHKRIMET NGA KRYESIA

Aprovuar nga Kryesia e Shoqatës në Chicago, 9 Nëntor 2015

Fatmir Jusufi, Kryetar

Sali Shabani, Zv. Kryetar

Samet Useini, Sekretar

Muhamed Beluli, Zv. Sekretar

Amit Baftiri, Arkëtar

Idriz Shabani, Zv. Arkëtar

Afrim Shabani, Anëtar

Rushit Ajroja, Anëtar

Lirim Ashiku, Anëtar

Ilir Zenku, Anëtar

Bardhyl Ahmedi, Anëtar



SHTOJCË – NDRYSHIMET NË STATUT

Statuti original u pregadit nga Kryesia e Shoqatës dhe u aprovua në Kuvendin e Përgjithshëm të Shoqatës në 28 Tetor 2013.



Ndryshimi i parë i Statutit u aprovua nga Kuvendi i Përgjithshëm i Shoqatës në 24 Mars 2014. Ndryshimet ishin emri i Shoqatës (nga "Kërçova" në "Uskana") dhe logo e re.

Ndryshimi i dytë i Statutit aprovohet nga Kuvendi i Përgjithshëm i Shoqatës në 9 Nëntor 2015. Ndryshimi i vetëm është shtesa e Recitalit AMA në objektivat e Shoqatës. (Neni 3, Pika i.)